

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E HËNË 3 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Kjo seancë vijon pas Javës së Gjelbër dhe, si e tillë, na ofron mundësinë të diskutojmë për problematikat në zonat tona. Pas observimesh, takimesh dhe vizitash që kemi kryer në FushëKrujë, duhet të them se dita-ditës situata në këtë zonë po ndryshon dhe problemet po thellohen. Dua ta nis fjalën time duke përmendur një shkollë të rëndësishme në këtë njësi administrative, e njohur si shkolla 9-vjeçare “Adem Gjeli”. Kjo shkollë gjendet në mes të qytetit të Fushë-Krujës dhe është një nga shkollat më të rëndësishme në qytet, me 1650 nxënës, të cilët zgjedhin të shkollohen aty. Ata sot detyrohen të zhvillojnë mësimin me dy turne, pasi mesatarisht janë 32 nxënës në çdo klasë.

Kushtet e kësaj shkolle lënë për të dëshiruar, ndërkohë që nxënësit dhe stafi akademik presin për një projekt të ri për shkollën e tyre të dashur. Pas një vizite në këtë shkollë vura re se ambientet e jashtme dhe të brendshme kanë nevojë për restaurim të menjëhershëm dhe duhet treguar vëmendje si nga pushteti lokal, edhe nga ai qendror, të cilët e kanë neglizhuar gjithë këtë kohë. Pas gjithë turit që bëra në këtë shkollë pashë që palestra është e dëmtuar, kam edhe fotografi, ku shihet se të gjitha muret janë të shkatërruara, nuk ka ndriçim dhe as higjienë të përshtatshme për të zhvilluar lëndët mësimore aty. Klasat po ashtu janë të vogla dhe të pamjaftueshme.

Do të doja që pas meje të qëndronte ministrja e Arsimit, por është ministrja e Shëndetësisë, sepse këto probleme janë më të thella nga ç’mendojmë, pasi flasim për nxënës, flasim për mësues e drejtorë, flasim për të gjithë ata që i kushtojnë vëmendje arsimit dhe ia dedikojnë jetën e tyre të përditshme. Ministria e Arsimit dhe ajo e Shëndetësisë duhet të marrin masa mbi ecurinë e mësimdhënies në këtë shkollë, pasi kushtet janë në gjendje të mjerueshme. Dua të

sjell në vëmendjen tuaj gjithashtu se shkolla në Nikël, “Ramazan Karaj”, e cila u cilësua me probleme nga tërmeti, para 6 muajsh u përfshi në projektin e rindërtimit nga EU4Schools. Kjo shkollë është sot e shembur dhe ende nuk kanë nisur punimet, duke i lënë nxënësit dhe stafin në pritje.

Duam të dimë, çfarë e pengon nisjen e punimeve dhe sa kohë do të duhet të presin nxënësit që të rikthehen në shkollën e tyre të mëparshme?! Gjithashtu, dua të theksoj se një problematikë shumë e rëndësishme është dhe në zonën e Bubqit, ku kanë nisur dy projekte të reja. Çështja e parë ka të bëjë me projektin “Operimi i inceneratorit për asgjësimin e mbetjeve shtazore”, një projekt i paraqitur nga Ministria e Bujqësisë, me rëndësi kombëtare, duke qenë se do të jetë në fokusin e karantinimit dhe incenerimit të mbetjeve shtazore.

Së pari, me lejon t’ju them se në kërkesën për informacion drejtuar këtij institucioni, mungon relacioni i parë i dëgjësës publike të kryer në Bilaj, në datën 17 korrik 2022, ku është firmosur një dokument nga unë dhe banorët e këtij fshati, ku jemi shprehur kategorikisht kundër mënyrës se si po procedohet në dhënien e informacioneve dhe se kërkojmë një tjetër dëgjësë publike me institucionet përkatëse për të marrë më shumë informacione. Dhe çfarë ndodhi? Në datën 1 gusht 2022 është mbajtur një tjetër seancë dëgjimore me publikun pa lajmëruar banorët, me një grup njerëzish të paautorizuar, mos qofshin ndoshta edhe në listën e patronazhistëve të Partisë Socialiste, ku janë dhënë firma të disa personave anonimë dhe të paautorizuar për të marrë peshën e këtij projekti mbi shpinë.

Dokumentin e kam unë dhe mund të them se janë 6 banorë, sikundër ishim 17-20 banorë që kemi dhënë firmat tona për të krijuar një mundësi për të marrë informacion për projekte me rëndësi kombëtare. Problemi qëndron se zona ku është menduar projekti, është një zonë e banuar dhe ngjitur me të gjendet pusi i ujit nr. 333, i cili rrezikon kontaminimin e ujit. Gjithashtu, nuk garantohej që nuk do të ketë kontaminim të ajrit, duke pasuar edhe në kontaminimin e tokës, e cila përdoret për bujqësi. Është e papranueshme mungesa e seriozitetit që tregohet nga qeveria. Tejkaloar këtij problemi dhe projekti, dua të shtoj gjithashtu faktin se ka një projekt tjetër, që ka impakt në zonë.

Dua të përmend këtu se, me nisjen e punimeve për aksin e ri Thumanë – Vorë – Kashar, ka pasur disa dëmtime në rrugën e Bilajt teksa kalojnë makinat e rënda, por ky nuk është problemi kryesor që shqetëson sot banorët. Tokat që përshkon rruga, janë toka bujqësore, janë toka private, ka shtëpi dhe kanë vlerë të rëndësishme për banorët dhe zonën. Çmimi referues, me të cilin duhet të bëhet dëmshpërblimi për pronat, duhet rishikuar dhe kërkesë e këtyre banorëve është të cilësohet gjurma e aksit të ri dhe se cilat prona do të shemben në këtë proces; çfarë do të ndodhë me shpronësimet. Duhet të ngrihet një komision, i cili të ketë mundësi të bëjë çdo analizë që duhet, çdo analizë të nevojshme për të riparë dhe për të rishikuar çmimet e referencës në lidhje me shpronësimet.

Gjithashtu, dua të them se në projektin që kam parë, vihet re se nuk ka një mbikalim, pra ka mungesën të mbikalimit ose të një rruge alternative, e cila do të bashkojë Bilajn. Nëse ne do ta presim në mes, pra do ta ndajmë fshatin në dy anë, si mundet që këto dy anë të fshatit, dy anë të së njëjtës rrugë, të lidhen me njëra-tjetrën? Në projekt nuk është menduar dhe shpresoj të ketë mundësi të rishikohet. Unë dua të theksoj se ky është një tjetër rast, ku ka mungesë të informacioneve dhe mungesë të transparencës që ofrohet për banorët. Ne kërkojmë rishikim të këtyre projekteve dhe të merret parasysh interesi i qytetarëve. Interesi i tyre është mbi çdo projekt që ju mund të jepni me koncesion, prandaj kërkojmë vëmendjen tuaj për këto shqetësime.

Duke e mbyllur fjalën time, dua të them se problemet po thellohen dita-ditës. Fushë-Kruja, Nikla dhe Bubqi sot po boshatisen. Duhet t'u kthejmë shpresën këtyre banorëve dhe rinisë shqiptare, por kjo nuk realizohet me gënjeshtër, propagandë, por realizohet me punë e vëmendje ndaj këtyre qytetarëve, se pasqyra e këtij kombi është rinia e tij. Faleminderit!